REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

**JANAR 2024**

# EKONOMIA DHE BUXHETI

## Raport Mujor

# EKONOMIA DHE BUXHETI

## Raport Mujor

## Janar 2024

© Ministria e Financave, 2024

Drejtoria e Përgjithshme e  Programimit Makroekonomik dhe Fiskal
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

**E-mail:** **Dajana.Metolli@financa.gov.al**

# Përmbajtja

**VEÇORITË KRYESORE ________________________________________________ 2**

**ZHVILLIMET EKONOMIKE ____________________________________________ 3**

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit __________________________________ 3
2. Kursi mesatar i Këmbimit ______________________________________ 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave _______________ 5
4. Bilanci i Pagesave ____________________________________________ 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar_____________________________ 7
6. Kredia për Ekonominë __________________________________________ 8
7. Oferta e Parasë _______________________________________________ 9
8. Depozitat sipas burimeve________________________________________ 10

**SEKTORI FISKAL _____________________________________________________ 11**

1. Buxheti i Konsoliduar ___________________________________________ 11
2. Të Ardhurat Sipas Burimeve _____________________________________ 12
3. Financimi i Bilancit Fiskal ________________________________________ 13

**ANEKSI STATISTIKOR _________________________________________________ 13**

# Veçoritë Kryesore

- Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin janar 2024, arriti në  116.42;
- Norma vjetore e inflacionit për muajin janar 2024 ishte 3.37 përqind;
- Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin janar 2024 ishte 95.33 lekë për dollarë dhe 103.91 lekë për euro;
- Normat mesatare të interesit të depozitave në lekë sipas individëve dhe korporatave jo-financiare gjatë muajit janar 2024 shënuan kuotën 1.51 dhe 3.12 përqind;
- Normat mesatare të interesit të huave në lekë sipas Individëve dhe korporatave jo-financiare gjatë muajit janar 2024 shënuan përkatësisht vlerat 6.66 dhe 7.03 përqind;
- Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,708,882 milionë lekë në muajin janar 2024, duke shënuar një rritje prej rreth 1.5 përqind krahasuar me një vit më parë;
- Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e tretë të 2023 rezultoi me rritjen e mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 354.2 milionë euro;
- Situata Buxhetore për periudhën janar 2024 rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej rreth 15.43 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një suficit prej 10.76 miliardë lekë;
- Të ardhurat gjithsej të realizuara për janar 2024, arritën në rreth 54.52 miliardë lekë ose afërsisht 8.3 përqind më shumë se muaji janar 2023 dhe 100.9 përqind realizim kundrejt planit të periudhës;
- Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë, arritën në rreth 39.09 miliardë lekë ose rreth 11.8  përqind më shumë se muaji janar 2023 dhe 90.4 përqind realizim kundrejt planit të periudhës;

# Zhvillimet Ekonomike

## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin janar 2024 shënoi 3.4%, duke reflektuar një rënie në krahasim me një vit më parë ku ky ndryshim shënoi 7.2%. Ndryshimi mujor i Indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK), në muajin janar 2024 krahasuar me dhjetor 2023 ka shënuar rritje me 0.5%. Referuar një viti më parë IÇK për muajin janar 2023 shënoi rritje mujore prej 1.1 % në krahasim me muajin paraardhës.

Fig. 1




*Ndryshimet mujore/vjetore të IÇK-*

Burimi: INSTAT

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, grupet të cilat patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin:

- "Ushqime dhe pije joalkolike" me rritje vjetore të çmimit prej +5.3%, duke kontribuar me +1.91 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.4%.
- "Qera, ujë, lëndë djegëse dhe energji" me rritje vjetore të çmimit prej +2.3%, duke kontribuar me +0.44 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.4%.
- "Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje", me rritje vjetore +5.0%, duke kontribuar me +0.37 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.4%.
- "Pije alkoolike dhe duhan" me rritje vjetore të çmimit prej +3.9%, duke kontribuar me +0.19 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.4%.
- "Hotele, kafene dhe restorante" me rritje vjetore të çmimit prej +4.0%, duke kontribuar me +0.18 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.4%.
- "Mallra dhe shërbime të ndryshme" me rritje vjetore të çmimit prej +3.4%, duke kontribuar me +0.18 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.4%.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

| VITI | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2023 | 7.2 | 7.1 | 5.3 | 4.6 | 4.7 | 4.5 | 4.2 | 4.0 | 4.1 | 3.8 | 3.9 | 4.0 |
| 2024 | 3.4 | | | | | | | | | | | |

***Burimi:*** *INSTAT*

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin janar 2024, arriti në 103.91 lekë/euro, duke shënuar rritje në vlerë me 1.10 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit janar, një euro u këmbye me 103.9 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin janar 2024 arriti në 95.33 lekë/dollarë duke shënuar rritje në vlerë me 1.23 përqind kundrejt një muaji më parë. Në fund të muajit janar, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 95.95 lekë/dollarë.

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, shënoi një nivel mesatar rreth 0.92 dollarë/euro për muajin janar 2024.

Fig. 2




**Ecuria e kursit të këmbimit Janar 2024**
Burimi: Banka e Shqipërisë

Në krahasim me muajin janar të vitit të kaluar, pas një periudhe të konsiderueshme forcimi, rezulton se monedha shqiptare ka pësuar një mbiçmim ndaj monedhës europiane në masën 10.72 përqind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është mbiçmuar në masën 11.65 përqind. Rënia e monedhës euro ka ardhur si pasojë e numrit të lartë të turistëve të huaj dhe të flukseve valutore hyrëse nga turizmi. Forcimi i monedhës vendase ndaj euros këtë vit ka ndihmuar në zbutjen e pjesshme të presioneve inflacioniste nga jashtë.

Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, forcimi i lekut mund të shpjegohet me përmirësimet në bilancin e llogarisë korrente, rritjen e invesimeve të huaja direkte, por edhe me efektet e normalizimit monetar dhe rritjes së normave të interesit si dhe si rezultat i stabilitetit të situatës makroekonomike në vend.

## 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit janar 2024, normat mesatare të interesit të depozitave me afat në lekë sipas Individëve dhe Korporatat jo-financiare shënuan përkatësisht vlerat prej 1.51 dhe 3.12 përqind. Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të depozitave sipas individëve kanë shënuar rënie me 0.13 pikë përqindje dhe Korporatat jo-financiare kanë shënuar rritje me 0.56 pikë përqindje. Ndërsa krahasuar me një vit më parë kanë shënuar rënie me 0.03 pikë përqindje për Individët dhe një rritje me 0.35 pikë përqindje për Korporatat jo-financiare.

Fig. 3




*Normat e interesit për depozitat sipas individëve, KJF dhe BTH-12M (në %)*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore për muajin janar 2024 kanë shënuar kuotën 3.48 përqind, nga 5.19 përqind që shënonte për të njëjtën periudhë një vit më parë. Bonoja 12-mujore shënoi rritje me 0.12 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë dhe rënie vjetore me 1.71 pikë përqindje.

Gjatë muajit janar 2024 normat mesatare të interesit të huave sipas Individëve dhe korporatave jo-financiare shënuan përkatësisht vlerat 6.66 dhe 7.03 përqind. Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të huave sipas individëve u rritën me 0.17 pikë përqindje ndërsa normat e interesit sipas korporatave jo-financiare u rritën me 0.44 pikë përqindje. Ndërsa krahasuar me një vit më parë kanë shënuar rënie me 0.52 pikë përqindje për Individët dhe janë rritur me 0.31 pikë përqindje për Korporatat jo-financiare.

Fig. 4




Normat e interesit për huatë sipas individëve (në %)

Burimi: Banka e Shqipërisë

# 4. Bilanci i Pagesave

Në nëntëmujorin e parë të vitit 2023, Bilanci i përgjithshëm i Pagesave rezultoi pozitiv, në rritje të mjeteve të rezervës valutore në vlerën 786 milion euro, nga -58 milion euro që ishte në nëntëmujorin e parë të 2022. Gjithashtu, vetëm për tremujorin e tretë të 2023, BP shënoi vlerën 160 milion euro, krahasuar me tremujorin e tretë të 2022 që shënoi vlerën 94 milion euro. Për nëntëmujorin e parë të vitit 2023, llogaria korente u zgjerua në 28 milion euro krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë që ishte -590 milion euro. Po ashtu, vetëm për tremujorin e tretë të 2023, llogaria korente u mbyll me balancë pozitive prej rreth 354 milion euro, krahasuar me deficitin e tremujorit të tretë të 2022 që ishte -145 milion euro.

Fig. 5




Bilanci i Pagesave T3 - 2023

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në nëntëmujorin e parë të vitit 2023, Llogaria financiare dhe kapitale u zgjerua në vlerën +720 milion euro krahasuar me +529 milion euro në nëntëmujorin e parë 2022. Ndërsa, vetëm për tremujorin e tretë të 2023, llogaria financiare dhe kapitale shënoi deficitin prej rreth -85 mln euro, krahasuar me suficitin prej rreth +127 mln euro në tremujorin e tretë të 2022.

Fig. 6




Llogaria Korente T3 - 2023

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në nëntëmujorin e parë të vitit 2023, Investimet e huaja direkte u zgjeruan në vlerën +1.088 miliardë euro ose +10.6%, krahasuar me +984 milion euro në nëntëmujorin e parë 2022. Ndërsa vetëm për tremujorin e tretë të 2023, IHD regjistruan vlerën +404 mln euro ose +17.4%, krahasuar me +344 mln euro në tremujorin e tretë të 2022.

## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit janar 2024, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 56,113 milionë lekë krahasuar me muajin janar 2023. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto në Bankat Paradepozituese me 36,755 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rritje me 4,554 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rritja mujore prej 22,003 milionë lekë në Bankat Paradepozituese.

Fig. 7




Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,708,882 milionë lekë në muajin janar 2024 duke shënuar një rritje prej rreth 25,976 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 1.5 përqind.

Në muajin janar, sistemi bankar rezulton me rritje mujore prej 10,650 milionë lekë.

Fig. 8




Agregati M3 Janar'24-Janar'23

Burimi: Banka e Shqipërisë

# 6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin janar 2024 arriti në rreth 740,996 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje në vlerë me 29,471 milonë lekë, ose rritje me rreth 4.14 përqind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (57.0%) dhe monedhave të huaja (43.0%).

Fig. 9




***Rritja e stokut total të kredive Janar'24***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë muajit janar 2024, zëri "Korporata të tjera jo-financiare", zuri peshën më të lartë të totalit të kredive, me rreth 56.0 përqind ose 414,846 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 38.8 përqind ose rreth 287,707 milionë lekë. Zërat "Korporata jo financiare publike" dhe "Korporata të tjera financiare" arritën respektivisht 2.5 dhe 2.7 përqind apo 18,445 dhe 19,905 milionë lekë.

Fig. 10




***Përberja e kredive Janar'24***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin janar 2024 zëri "Koorporata të tjera jofinanciare" zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 69.16 përqind, ndjekur nga "Sektorë të tjerë rezidentë" me rreth 25.44 përqind. "Koorporata të tjera financiar" dhe "Koorporata jofinanciare publike" kontribuojnë përkatësisht me 1.92 dhe 3.09 përqind secili.

# 7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 388.326 milionë lekë në fund të muajit janar 2024. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në janar 2024 ka shënuar një rënie mujore prej 0.45 përqind dhe rënie vjetore prej 0.30 përqind, duke arritur nivelin 22.7 përqind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar rënie mujore prej 0.76 përqind, dhe rënie vjetore prej 0.51 përqind, duke shënuar nivelin 29.41 përqind.

Fig. 11




*Raporte të parasë jashtë bankave me M3 & Depozitat Janar'24*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin janar 2024, kanë shënuar rënie vjetore prej 11,875 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 73.3 përqind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë gjatë muajit janar 2024 shënuan rritje prej 37,030 milionë lekë në krahasim me muajin janar 2023. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 73.4 përqind të depozitave në lekë.

Fig. 12




Raporti i Depozitave ndaj M3 Janar'24

Burimi: Banka e Shqipërisë

# 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit janar 2024, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 73.4 përqind, ndjekur nga “Koorporata të tjera jofinanciare”, me rreth 20.6 përqind dhe nga “Koorporata jo-financiare publike” me 4.2 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Koorporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 73.3 përqind dhe rreth 23.9 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 73.3 përqind e totalit.

Fig. 13




Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 968.206 milionë lekë të depozitave totale. Ato ndiqen nga “Koorporata të tjera jofinanciare” (296.083 milionë lekë), “Koorporata të tjera financiare” (22.565 milionë lekë), dhe “Koorporata jofinanciare publike” (31.338 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth (2.364 milionë lekë) në totalin e depozitave. Gjatë muajit janar 2024, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1,320,556 milionë lekë.

Fig. 14




Përberja e depozitave Janar'24

Burimi: Banka e Shqipërisë

Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rritje prej rreth 15.879 milionë lekë. Ndërsa, krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 25.155 milionë lekë

# Sektori Fiskal

## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën janar 2024 janë mbledhur rreth 54.516 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 39.090 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 38.576 miliardë lekë shpenzimet korrente dhe rreth 16.709 miliardë lekë shpenzimet për fonde speciale.

Fig. 15




*Treguesit Fiskal,Janar'24*

Burimi: Ministria e Financave

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 36.346 miliardë lekë (0.8% më pak se plani i periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor janë rreth 1.447 miliardë lekë (2.8% më shumë se plani i periudhës). Të ardhurat nga fondet speciale janë rreth 14.797 miliardë lekë (ose rreth 7.3% më shumë se plani i periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 1.758 miliardë lekë (ose rreth 5.2% më pak se plani i periudhës).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 38.576 miliardë lekë, 8.461 miliardë lekë (21.93% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 6.870 miliardë lekë (17.80% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime interesi, 1.784 miliardë lekë (4.62% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 39 milionë lekë (0.10% e totalit të shpenzimeve korrente) për subvencione, 16.709 miliardë lekë (43.31%) për shpenzime për fonde speciale, 3.040 miliardë lekë (7.88% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 1.674 miliardë lekë (4.33% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime të tjera.

## 2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar 2024 ishin rreth 54.5 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 52.6 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 1.8 miliardë lekë.

**Tab - 2** **Të ardhurat tatimore gjatë muajit Janar 2024 (mln Lekë)**

| Emërtimi | Janar'24 | Janar'23 | Janar'24/Janar'23 Rritja në (%) |
|---|---|---|---|
| Tatimi mbi Vleren e Shtuar | 18,310 | 16,977 | 7.8 |
| Tatimi mbi Fitimin | 2,859 | 2,397 | 19.3 |
| Akcizat | 4,299 | 4,102 | 4.8 |
| Tatimi mbi të Ardhurat Personale | 5,710 | 5,258 | 8.6 |
| Taksa Nacionale dhe të tjera | 4,528 | 4,023 | 12.6 |
| Taksa Doganore | 639 | 584 | 9.5 |

*Burimi:* Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Janar 2024

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Sufiçiti prej 15.4 miliardë lekë për periudhën janar 2024 u përdor për huamarrjen afatgjatë të brendshme si mjeti kryesor i financimit si dhe për huamarrjen e huaj.

Për periudhën janar 2024, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 54.516 miliardë lekë,
- Realizimi i shpenzimeve në masën 39.090 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave progresive për periudhën janar 2024, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 52.589 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 38.576 miliardë lekë dhe shpenzimet për fonde speciale me rreth 16.709 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

Tab - 1

| Muaji | Mujor (Monthly) | | | | | Mesatar Mujor (Monthly | | | | | Vjetor (Annual) | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | Month |
| **Janar** | 1.9 | 1.3 | 1.3 | 1.1 | **0.5** | 1.9 | 1.3 | 1.3 | 1.1 | **0.5** | 1.5 | 0.4 | 3.7 | 7.2 | **3.4** | **January** |
| Shkurt | 0.4 | 1.1 | 1.3 | 1.1 | | 1.1 | 1.2 | 1.3 | 1.1 | | 1.2 | 1.1 | 3.9 | 7.1 | | February |
| Mars | 0.6 | 0.7 | 2.4 | 0.7 | | 0.9 | 1.0 | 1.7 | 1.0 | | 2.1 | 1.2 | 5.7 | 5.3 | | March |
| Prill | -0.4 | 0.2 | 0.7 | 0.03 | | 0.6 | 0.8 | 1.4 | 0.9 | | 1.9 | 1.9 | 6.2 | 4.6 | | April |
| Maj | -0.8 | -0.9 | -0.5 | -0.3 | | 0.3 | 0.5 | 1.0 | 0.7 | | 2.1 | 1.8 | 6.7 | 4.7 | | May |
| Qershor | -0.6 | -0.8 | -0.1 | -0.3 | | 0.2 | 0.3 | 0.9 | 0.6 | | 1.8 | 1.6 | 7.4 | 4.5 | | June |
| Korrik | -0.5 | 0.1 | 0.2 | -0.1 | | 0.1 | 0.2 | 0.8 | 0.5 | | 1.4 | 2.2 | 7.5 | 4.2 | | July |
| Gusht | 0.2 | 0.4 | 0.8 | 0.6 | | 0.1 | 0.3 | 0.8 | 0.5 | | 1.3 | 2.4 | 8.0 | 4.0 | | August |
| Shtator | 0.4 | 0.5 | 0.6 | 0.7 | | 0.1 | 0.3 | 0.7 | 0.4 | | 1.5 | 2.5 | 8.1 | 4.1 | | September |
| Tetor | 0.2 | 0.1 | 0.4 | 0.1 | | 0.1 | 0.3 | 0.7 | 0.4 | | 2.0 | 2.4 | 8.3 | 3.8 | | October |
| Nëntor | -0.5 | 0.2 | -0.3 | -0.2 | | 0.1 | 0.3 | 0.6 | 0.3 | | 1.6 | 3.1 | 7.9 | 3.9 | | November |
| Dhjetor | 0.3 | 0.8 | 0.4 | 0.5 | | 0.1 | 0.3 | 0.6 | 0.3 | | 1.1 | 3.7 | 7.4 | 4.0 | | December |

***Burimi*** *: INSTAT* ***Source*** *: INSTAT*

**Tab - 2** **Kursi i këmbimit**
*Exchange rate*

| Monedha | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 Janar January | Currency |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ***Mesatarja e periudhës*** | | | | | | ***Average of period*** |
| USD | 108.65 | 103.68 | 113.04 | 100.65 | **95.33** | USD |
| EURO | 123.77 | 122.37 | 118.98 | 108.80 | **103.91** | EURO |
| ***Fundi i periudhës*** | | | | | | ***In the end of period*** |
| USD | 100.84 | 106.54 | 107.05 | 93.94 | **95.95** | USD |
| EURO | 123.70 | 120.76 | 114.23 | 103.88 | **103.90** | EURO |

***Burimi** : Banka e Shqipërisë* ***Source** : Bank of Albania*

Tab - 3 **Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)**
*Annual Interest Rates (in ALL)*

| Në përqindje | 2024<br>Janar<br>January | In percent |
|---|---|---|
| *Norma e interesit të depozitave për individë* | | *Interest rates on households deposits* |
| Deri në 1 vit | 1.03 | Up to 1 year |
| Nga 1-2 vite | 1.61 | From 1 to 2 years |
| Mbi 2 vjet | 2.98 | Over 2 years |
| *Norma e interesit të depozitave për korporatat jo-fir* | | *Interest rates on nonfinancial corporations deposits* |
| Deri në 1 vit | 3.01 | Up to 1 year |
| Nga 1-2 vite | 2.56 | From 1 to 2 years |
| Mbi 2 vjet | 4.83 | Over 2 years |
| *Normat e interesit të kredive per individet* | | *Interest rates on household loans* |
| Kredi për banesa | 4.35 | Lending for house purchase |
| Kredi konsumatore | 9.89 | Consumer credit |
| Kredi për qëllime të tjera | 10.46 | Credit for other purposes |
| *Normat e interesit të kredive per korporatat jofinan* | | *Interest rates on nonfinancial corporations loans* |
| Kredi deri në 140 milion lekë | 6.86 | Loans up to to an amount of 140 millions of lek |
| Kredi mbi 140 milionë lekë | 7.35 | Loans over an amount of 140 millions of lek |
| *Norma e letrave me vlerë* | | *Securities rates* |
| Bono thesari 1/ | | Treasury bills 1/ |
| 3-M | 3.09 | 3-M |
| 6-M | - | 6-M |
| 12-M | 3.48 | 12-M |

**Burimi :** *Banka e Shqipërisë* — **Source :** *Bank of Albania*

Tab - 4

**TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2024**

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2024

*Të dhëna progresive (Progresive Data)* *në milionë Lekë (in million ALL)*

| Nr. | E M Ë R T I M I | January Janar | ITEMS |
|---|---|---|---|
| | **TOTALI TË ARDHURAVE** | **54,516** | **TOTAL REVENUE** |
| **I.** | **Të ardhura nga ndihmat** | **170** | **Grands** |
| **II.** | **Të ardhura tatimore** | **52,589** | **Tax Revenue** |
| **II.1** | **Nga Tatimet dhe Doganat** | **36,346** | **From tax offices and customs** |
| 1 | Tatimi mbi Vlerën e Shtuar | 18,310 | V.A. T |
| 2 | Tatimi mbi Fitimin | 2,859 | Profit Tax |
| 3 | Akcizat | 4,299 | Excise Tax |
| 4 | Tatimi mbi të Ardhurat Personale | 5,710 | Personal Income Tax |
| 5 | Taksa Nacionale dhe të tjera | 4,528 | National Taxes and others |
| 6 | Taksa Doganore | 639 | Customs Duties |
| **II.2** | **Të ardhura nga Pushteti Vendor** | **1,447** | **Revenues from Local Gov.** |
| 1 | Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat) | 257 | Property Tax |
| 2 | Taksë mbi Biznesin e vogël | 7 | Small Business Tax |
| 3 | Taksa Lokale | 1,182 | Local Taxes |
| **II.3** | **Të ardh nga fondet speciale** | **14,797** | **Social ins. contributions** |
| 1 | Sigurimi Shoqeror | 12,748 | Social Insurance |
| 2 | Sigurimi Shëndetsor | 2,013 | Health insurance |
| 3 | Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve | 35 | Compensation income in the value of owners |
| **III.** | **Të ardhura Jotatimore** | **1,758** | **Nontax Revenue** |
| 1 | Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë | 0 | Profit transfer from BOA |
| 2 | Të ardhura nga Inst.Buxhetore | 1,023 | Income of budgetary institutions |
| 3 | Tarifat shërbimeve | 246 | Utility fees |
| 4 | Të tjera | 489 | Others |
| | **TOTALI I SHPENZIMEVE** | **39,090** | **TOTAL EXPENDITURE** |
| **I.** | **Shpenzime Korrente** | **38,576** | **Current Expenditures** |
| **I.1** | **Personeli** | **8,461** | **Personnel expenditures** |
| 1 | Paga | 7,264 | Wages |
| 2 | Kontributi për Sigurime Shoqerore | 1,183 | Social insurance contributions |
| 3 | Arsimi I larte nga te ardhurat e veta | 13 | Higher education from its own income |
| **I.2** | **Interesat** | **6,870** | **Interest** |
| 1 | Të Brendshme | 5,767 | Domestic |
| 2 | Të Huaja | 1,103 | Foreign |
| **I.3** | **Shpenzime Operative Mirëmbajtje** | **1,784** | **Operational & Maintenance** |
| **I.4** | **Subvecionet** | **39** | **Subsidies** |
| **I.5** | **Shpenzime për fonde speciale** | **16,709** | **Social insurance outlays** |
| 1 | Sigurime Shoqerore | 13,306 | Social insurance |
| 2 | Sigurime Shëndetsore | 3,403 | Health insurance |
| 3 | Fondi I kompensimit të pronarëve | 0 | Owners' Compensation Fund |
| **I.6** | **Shpenzime per Buxhetin Vendor** | **3,040** | **Local budget expenditure** |
| **I.7** | **Shpenzime të tjera** | **1,674** | **Other expenditures** |
| 1 | Pagesa e Papunesisë | 61 | Unemployment insurance benefits |
| 2 | Ndihma Ekonomike | 1,513 | Economic Aid |
| 3 | Bonusi I lindjeve | 100 | Birth bonus |
| **I.8** | **Transferime Kapitale** | **0** | **Capital transfers** |
| **II** | **Fondi Rezerve, Kontigjenca** | **0** | **Reserve fund/contigency** |
| **III** | **Shpenzime Kapitale** | **513** | **Capital expenditures** |
| 1 | Financimi Brendshëm | 0 | Domestically financing |
| 2 | Investime nga te ardhurat e Arsimit te Larte | 0 | From higer education system's own revenues |
| 3 | Financimi Huaj | 513 | Foreign financed |
| **IV** | **Fondi i rindertimit** | **0** | **Reconstruction fund** |
| **V.** | **DEFICITI** | **15,426** | **CASH BALANCE** |
| **V.1** | **FINANCIMI DEFICITIT** | **-15,426** | **CASH BALANCE FINANCING** |
| **V.2** | **Brendshëm** | **-12,183** | **Domestic** |
| 1 | Të ardhura nga privatizimi | 1 | Privatization receipts |
| 2 | Hua-marrje e brendshme | -12,000 | Domestic new borrowing (net) |
| 3 | Të tjera | -184 | Others |
| **V.3** | **I huaj** | **-3,243** | **Foreign** |
| 1 | Hua afatgjatë(e marrë) | 348 | Long-term foreign borrowing (gross) |
| 2 | Ndryshimi i gjendjes së arkes* | 8 | Chang. of stat. Account |
| 3 | Ripagesat | -3,599 | Repayments |
| 4 | Mbështetje Buxhetore | 0 | Budgetary Support |

***Burimi** : Ministria e Financave* ***Source** : Ministry of Finance*

Tab - 5

**Tabela e investimeve 2024**

*Table of investments 2024*

*Të dhëna progresive (Progresive Data)*

| | Janar<br>January | |
|---|---|---|
| **Financim i brendshëm** | **-12,183** | **Domestic financing** |
| *Në %* | 79.0 | *In %* |
| **Financim i huaj** | **-3,243** | **Foreign financing** |
| *Në %* | 21.0 | *In %* |
| **Totali** | **-15,426** | **Total** |
| *Në %* | 100 | *In %* |

**Burimi**: Ministria e Financave

**Source**: Ministry of Finance

Tab - 6 **TË ARDHURAT DOGANORE DHE TATIMORE 2024**
**CUSTOMS AND TAX REVENUES 2024**

*Të dhëna progresive (Progresive Data)* *në milionë Lekë ( in million ALL)*

| | Janar<br>January | |
|---|---|---|
| Taksë doganore | 639 | Customs Duties |
| TVSH | 9,908 | V.A.T |
| Akcizë | 4,299 | Excises |
| Të tjera (Renta Minerare) | 187 | Others (Mineral Rent) |
| **TOTALI** | **15,034** | **Total** |
| **TË ARDHURAT TATIMORE 2023 (TAX REVENUE)** | | |
| TVSH | 8,402 | V.A.T |
| Tatim mbi fitimin | 2,859 | Profit Tax |
| Tatimi mbi të ardhurat personale | 5,710 | Personal income tax |
| Taksa nacionale dhe të tjera | 4,341 | National taxes |
| **TOTALI** | **21,312** | **Total** |
| **TOTALI I PËRGJITHSHËM** | **36,346** | **OVERALL TOTAL** |

**Burimi:** Ministria e Financave

**Source:** Ministry of Finance

Tab - 7

**DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2024**

*The Deficit and Its Financing for 2024*

*Të dhëna progresive (Progresive Data)* *Në milionë lekë (In million ALL)*

| | Janar January | |
|---|---|---|
| **TË ARDHURAT** | **54,516** | **REVENUE** |
| **SHPENZIMET** | **39,090** | **EXPENDITURES** |
| **BILANCI FISKAL** | **15,426** | **FISCAL BALANCE** |
| **FINANCIMI I BILANCIT FISKAL** | **-15,426** | **FINANCING** |
| **Financimi i brendshëm** | **-12,183** | **Domestic** |
| Të ardhura nga privatizimi | 1 | Privatization receipts |
| Hua-marrje e brendshme | -12,000 | Domestic borrowing |
| Të tjera | -184 | Others |
| | | |
| **Financimi i jashtëm** | **-3,243** | **Foreing** |
| a. Hua afatgjatë(e marrë) | 348 | Long-term foreign borrowing (gross) |
| b. Ndryshimi i gjendjes së arkes* | 8 | Chang. of stat. Account |
| c. Ripagesat | -3,599 | Repayments |
| d. Mbështetje Buxhetore | 0 | Budgetary Support |

**Burimi:** Ministria e Financave **Source:** Ministry of Finance

| Tab - 8 | **BILANCI I PAGESAVE** |
|---|---|
| | *Balance of payments* |

*Në milion Euro* *In millions Euro*

| | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | T1-2023 | T2-2023 | T3-2023 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Llogaria korrente** | **-1,088.70** | **-1,152.60** | **-1,166.43** | **-1,063.27** | **-128.06** | **-195.33** | **354.29** | **Current Account.** |
| **Bilanci tregtar** | **-3,143.80** | **-2,982.51** | **-3,829.34** | **-4,268.90** | **-890.93** | **-1,220.04** | **-1,207.39** | **Trade Balance.** |
| Eksporti I mallrave fob | 906.50 | 793.63 | 1,264.79 | 1,932.55 | 486.85 | 425.47 | 420.09 | Merchandise Exports. Fob |
| Importi I mallrave fob | -4,050.30 | -3,776.14 | -5,094.13 | 6,201.59 | 1,377.78 | 1,645.51 | 1,627.48 | Merchandise Imports. Fob |
| **Bilanci i shërbimeve** | **1,263.90** | **1,051.72** | **1,776.10** | **2,401.33** | **564.17** | **793.95** | **1,322.35** | **Services Balance.** |
| Shërbimet Kredi | 3,404.60 | 2,226.22 | 3,466.03 | 4,801.38 | 1,198.01 | 1,522.43 | 2,359.44 | Services Credit |
| Shërbimet Debi | 2,140.70 | 1,174.50 | 1,689.93 | 2400.05 | 633.84 | 728.48 | 1037.1 | Services Debt |
| **Bilanci i të ardhurave** | **-180.10** | **-219.34** | **-210.93** | **-314.76** | **-72.09** | **-68.98** | **-64.50** | **Balance of Incomes** |
| Të ardhurat Kredi | 420.20 | 337.10 | 397.57 | 596.79 | 155.36 | 186.02 | 198.51 | Income Credit |
| Të ardhurat Debi | -600.30 | -556.44 | 608.55 | 911.54 | 227.45 | 254.99 | 263.01 | Income Debt |
| **Bilanci i transfertave** | **971.30** | **997.40** | **1,077.96** | **1,119.05** | **270.74** | **299.74** | **303.83** | **Balance of Transfers** |
| Transferta private | 1,105.50 | 1,169.70 | 1,244.00 | 1,280.21 | 309.69 | 342.17 | 347.68 | Private Unrequired Transfers |
| Transfertat shtetërore | -134.20 | -172.30 | -166.04 | 161.16 | 38.95 | 42.43 | 43.85 | Offical Unrequired Transfers |
| **Llogaria kapitale** | **76.10** | **143.60** | **358.46** | **20.13** | **-27.54** | **119.32** | **-40.23** | **Capital Account** |
| **Llogaria financiare** | **-827.00** | **-1,504.34** | **-1,564.51** | **-819.20** | **-128.41** | **-575.12** | **45.10** | **Financial Account** |
| Investime direkte | -1,036.30 | -893.56 | -989.93 | -1,189.95 | -256.84 | -302.90 | -343.00 | Direct Investment |
| Investime portofoli | 140.60 | -65.85 | -96.46 | 573.11 | 14.99 | -306.97 | 312.68 | Portofolio Investment |
| Investime të tjera | 50.90 | -403.83 | -531.66 | -264.84 | 93.58 | 24.00 | 34.80 | Other Capital |
| **Gabime dhe harresa neto** | **107.90** | **159.32** | **178.83** | **154.14** | **110.47** | **43.50** | **-108.80** | **Net errors and omissions** |
| **Bilanci i përgjithshëm** | **-77.70** | **654.66** | **935.37** | **-69.80** | **83.28** | **542.61** | **160.15** | **Overall Balance** |
| Rezervat | -77.70 | 654.65 | 936.17 | -69.80 | 83.28 | 542.62 | 160.15 | Reserve Assets |
| Përdor kred & huash nga FMN | -17.80 | 141.10 | -53.54 | -62.48 | -19.86 | -10.75 | -40.60 | Use of Fund Credit and Loans |

**Burimi** : *Banka e Shqipërisë* **Source** : *Bank of Albania*

Tab - 9 **MJETET VALUTORE NETO**

*Net Foreign Assets*

| Në milionë Lekë<br>Fundi i periudhes | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024<br>Janar<br>January | 2023<br>Millions of Lek<br>End of Period |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Mjete valutore neto** | 803,487 | 937,814 | 892,687 | 934,539 | 979,164 | **Net foreign assets** |
| Pretendime ndaj jorezidentëve | 860,750 | 1,027,069 | 981,133 | 1,015,832 | 1,067,623 | Claims on nonresidents |
| Minus Detyrime të jorezidentëve | 57,263 | 89,255 | 88,446 | 81,293 | 88,459 | Minus: Liabilities to nonresidents |
| **Mjetet e brendshme** | 1,047,835 | 1,084,106 | 1,211,348 | 1,186,624 | 1,240,128 | **Domestic assets** |
| Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore | 435,613 | 412,253 | 491,750 | 462,149 | 492,892 | Net claims on central government |
| Pretendime ndaj sektoreve te tjere | 612,221 | 671,852 | 719,598 | 724,475 | 747,237 | Claims on other sectors |
| **Detyrimet e parasë së gjerë** | 1,456,993 | 1,582,310 | 1,659,293 | 1,660,053 | 1,708,882 | **Broad Money liabilities** |
| Paraja jashtë Korporatave Depozituese | 344,560 | 366,251 | 387,652 | 389,052 | 388,326 | Money outside depository corporations |
| Depozita të transferueshme | 490,394 | 584,631 | 645,637 | 654,894 | 702,764 | Transferable deposits |
| Depozita të tjera | 622,039 | 631,428 | 626,005 | 616,107 | 617,792 | Other deposits |
| **Depozita të papërfshira në paranë e gjërë** | 186,892 | 222,409 | 248,219 | 254,320 | 255,655 | **Deposits excluded from Broad Money** |
| Qeveria lokale dhe administrata publike | | | | | | Local government and public administration |
| Korporata të tjera financiare | 4,666 | 5,877 | 7,250 | 7,370 | 8,579 | Other financial corporations |
| Korporata jofinanciare publike | 252 | 392 | 382 | 374 | 338 | Public nonfinancial corporations |
| Korporata të tjera jofinanciare | 6,925 | 16,599 | 10,186 | 12,357 | 16,072 | Other nonfinancial corporations |
| Sektorë të tjerë rezidentë | 175,050 | 199,541 | 230,401 | 251,971 | 279,855 | Other resident sectors |
| **Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet** | 5,926 | 7,288 | 7,925 | 8,873 | 13,307 | **Securities other than shares** |
| Korporata të tjera jofinanciare | 57 | 67 | 291 | 668 | 608 | Korporata të tjera jofinanciare |
| Sektorë të tjerë rezidentë | 5,869 | 7,221 | 7,634 | 8,205 | 12,699 | Other resident sectors |
| **Huatë** | 3,757 | 3,507 | 4,636 | 5,802 | 9,642 | **Loans** |
| Qeveria lokale dhe administrata publike | | | | | | Local government and public administration |
| Korporata të tjera financiare | 3,757 | 3,507 | 4,636 | 5,802 | 9,642 | Other financial corporations |
| Korporata jofinanciare publike | | | | | | Public nonfinancial corporations |
| Korporata të tjera jofinanciare | | | | | | Other nonfinancial corporations |
| Sektorë të tjerë rezidentë | | | | | | other rezident sectors |
| **Llogari të pagueshme** | 62 | 248 | 86 | 125 | 363 | **Accounts payable** |
| Korporata të tjera Financiare | | | | | | Other financial corporations |
| Korporata jofinanciare publike | | | | | | Public nonfinancial corporations |
| Korporata të tjera jofinanciare | 5 | | 69 | 20 | 1 | Other nonfinancial corporations |
| Sektorë të tjerë rezidentë | 57 | 247 | 17 | 105 | 362 | other rezident sectors |
| **Aksione dhe instrumenta të tjerë të kapitalit** | 214,394 | 219,725 | 185,627 | 185,828 | 197,891 | **Shares and other equity** |
| Nga të cilat rezerva rivlerësimi | -1,095 | -5,442 | -46,110 | -63,348 | -70,979 | Of which: Valuation adjustment |
| **Të tjera neto** | -17,621 | -14,428 | -12,607 | -13,287 | -16,665 | **Other items net** |
| Detyrime të tjera | 55,892 | 59,094 | 63,859 | 63,136 | 65,486 | Other liabilities |
| Minus: Mjete të tjera | 73,514 | 73,521 | 76,467 | 76,423 | 82,151 | Minus: Other assets |
| **Axhustimi i konsolidimit** | 919.0 | 862 | 4,826 | 1,191 | 1,030 | **Consolidation adjustment** |

***Burimi*** *: Banka e Shqiperisë* ***Source*** *: Bank of Albania*

Tab - 10 **KREDIA PËR EKONOMINË**

*Credit to Economy*

| Në milion Lekë<br>Fundi i periudhës | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024<br>Janar<br>January | Million of Lek<br>End of Period |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Totali i kredisë** | 608,779.8 | 666,178.4 | 713,289 | 744,162.7 | 740,996.2 | **Total Credit** |
| **Kredia për qeverinë lokale dhe administratën publike** | 429.1 | 313.2 | 205 | 103.0 | 93.8 | **Credits to local Government** |
| Në lekë | 429.1 | 313.2 | 205 | 103.0 | 93.8 | in Lek |
| Në valutë | - | - | | | | in Foreingn Currency |
| **Kredia për korporatat jofinanciare publike** | 15,150.8 | 22,521.8 | 23,714 | 16,754.0 | 18,445.2 | **Credits to Public Non-financial Corporations** |
| Në lekë | 11,819.6 | 9,210.6 | 10,509 | 9,247.1 | 8,833.1 | in Lek |
| Në valutë | 3,331.2 | 13,311.3 | 13,205 | 7,506.9 | 9,612.1 | in Foreingn Currency |
| **Kredia për korporatat e tjera jofinanciare** | 370,356.3 | 395,162.7 | 411,853 | 421,985.1 | 414,845.7 | **Credits to other Non-financial Corporations** |
| Në lekë | 161,975.3 | 172,000.2 | 173,607 | 196,936.3 | 194,631.7 | in Lek |
| Në valutë | 208,381.0 | 223,162.5 | 238,246 | 225,048.8 | 220,214.0 | in Foreingn Currency |
| **Kredia për korporatat e tjera financiare** | 13,169.1 | 13,815.7 | 15,557 | 19,468.3 | 19,904.5 | **Credits to Other Financial Corporations** |
| Në lekë | 7,489.2 | 7,772.8 | 8,669 | 12,411.3 | 12,330.7 | in Lek |
| Në valutë | 5,679.9 | 6,043.0 | 6,888 | 7,057.0 | 7,573.8 | in Foreingn Currency |
| **Kredia për sektorë të tjerë rezidentë** | 209,674.5 | 234,365.0 | 262,223 | 285,852.0 | 287,707.1 | **Credits to other resident sectors** |
| Në lekë | 138,986.4 | 158,093.0 | 175,901 | 204,247.5 | 206,700.0 | in Lek |
| Në valutë | 70,688.1 | 76,272.0 | 86,322 | 81,604.7 | 81,007.1 | in Foreingn Currency |

***Burimi*** *: Banka e Shqiperisë* — ***Source*** *: Bank of Albania*

Tab - 11

**OFERTA E PARASË**

*Money Supply*

***Mujor-Monthly***

| Në milion Lekë<br>Fundi i periudhës | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024<br>Janar<br>January | Millions of LEK<br>End of Period |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Baza monetare | 480,352 | 573,510 | 539,812 | 584,588 | 567,139 | Monetary base |
| Paraja jashtë korporatave depozituese | 344,560 | 366,251 | 387,652 | 393,555 | 388,326 | Currency outside depository corporations |
| Agregati M1 | 637,317 | 701,404 | 735,839 | 772,513 | 779,977 | M1 Aggregate |
| Agregati M2 | 862,338 | 918,474 | 939,309 | 972,613 | 981,446 | M2 Aggregate |

***Burimi** : Banka e Shqiperisë*

***Source** : Bank of Albania*

Tab - 12 **DEPOZITAT**

*Deposits* *Mujor-Monthly*

| Në milionë Lekë<br>Fundi i periudhës | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024<br>Janar<br>January | Millions of Leks<br>End of Period |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Totali i depozitave** | 1,112,433 | 1,216,059 | 1,271,642 | 1,271,001 | 1,320,556 | |
| **Në lekë** | 517,778 | 552,223 | 551,657 | 550,867 | 593,120 | |
| ***Depozitat e transferueshme*** | 241,316 | 276,074 | 291,263 | 296,115 | 337,465 | ***Transferable deposits*** |
| Qeveria lokale dhe administrata publike | 1,644 | 1,302 | 1,694 | 1,868 | 1,985 | Local governments and public administration |
| Korporata jofinanciare publike | 13,747 | 17,118 | 16,031 | 17,002 | 21,460 | Public nonfinancial corporations |
| Korporata të tjera financiare | 3,666 | 4,744 | 7,045 | 5,037 | 4,552 | Other financial corporations |
| Korporata të tjera jofinanciare | 66,074 | 77,758 | 77,667 | 82,550 | 108,382 | Other nonfinancial corporations |
| Sektorë të tjerë rezidentë | 156,185 | 175,154 | 188,826 | 189,658 | 201,087 | Other resident sectors |
| ***Depozita me likuiditet të lartë (Depozita pa afat)*** | 51,442 | 59,079 | 56,924 | 54,735 | 54,186 | ***Liquid deposits (Sight deposits)*** |
| Qeveria lokale dhe administrata publike | | | | | | Local governments and public administration |
| Korporata jofinanciare publike | 166 | 1,762 | 2,636 | 1,335 | 847 | Public nonfinancial corporations |
| Korporata të tjera financiare | 131 | 78 | 37 | 19 | 0 | Other financial corporations |
| Korporata të tjera jofinanciare | 3,970 | 3,554 | 2,493 | 3,339 | 3,562 | Other nonfinancial corporations |
| Sektorë të tjerë rezidentë | 47,175 | 53,686 | 51,758 | 50,042 | 49,776 | Other resident sectors |
| ***Depozita të tjera*** | 225,021 | 217,070 | 203,470 | 200,041 | 201,469 | ***Other deposits*** |
| Qeveria lokale dhe administrata publike | 10 | | | | | Local governments and public administration |
| Korporata jofinanciare publike | 1,465 | 757 | 598 | 1,156 | 2,355 | Public nonfinancial corporations |
| Korporata të tjera financiare | 4,868 | 5,136 | 5,114 | 4,790 | 4,833 | Other financial corporations |
| Korporata të tjera jofinanciare | 6,836 | 7,598 | 6,379 | 7,799 | 10,043 | Other nonfinancial corporations |
| Sektorë të tjerë rezidentë | 211,841 | 203,579 | 191,379 | 186,272 | 184,238 | Other resident sectors |
| **Në valutë** | 594,655 | 663,836 | 719,985 | 720,134 | 727,436 | **In foreign currency** |
| ***Depozitat e transferueshme*** | 249,078 | 308,556 | 354,374 | 358,779 | 365,299 | ***Transferable deposits*** |
| Qeveria lokale dhe administrata publike | 82 | 39 | 76 | 105 | 158 | Local governments and public administration |
| Korporata jofinanciare publike | 2,246 | 2,465 | 3,901 | 4,429 | 3,738 | Public nonfinancial corporations |
| Korporata të tjera financiare | 6,742 | 6,143 | 6,598 | 6,447 | 5,139 | Other financial corporations |
| Korporata të tjera jofinanciare | 90,281 | 116,544 | 136,911 | 142,265 | 145,956 | Other nonfinancial corporations |
| Sektorë të tjerë rezidentë | 149,726 | 183,366 | 206,889 | 205,533 | 210,308 | Other resident sectors |
| ***Depozita me likuiditet të lartë (Depozita pa afat)*** | 120,699 | 136,407 | 139,409 | 132,046 | 129,955 | ***Liquid deposits (Sight deposits)*** |
| Qeveria lokale dhe administrata publike | | | | | | Local governments and public administration |
| Korporata jofinanciare publike | 97 | 94 | 101 | 60 | 6 | Public nonfinancial corporations |
| Korporata të tjera financiare | 1 | 10 | 1 | 5 | 0 | Other financial corporations |
| Korporata të tjera jofinanciare | 5,845 | 3,739 | 4,702 | 5,787 | 6,210 | Other nonfinancial corporations |
| Sektorë të tjerë rezidentë | 114,755 | 132,565 | 134,605 | 126,193 | 123,737 | Other resident sectors |
| ***Depozita të tjera*** | 224,878 | 218,873 | 226,202 | 229,309 | 232,182 | ***Other deposits*** |
| Qeveria lokale dhe administrata publike | | 24 | 984 | 209 | 219.3 | Local governments and public administration |
| Korporata jofinanciare publike | 1,732 | 1,519 | 2,607 | 2,645 | 2,931 | Public nonfinancial corporations |
| Korporata të tjera financiare | 6,939 | 8,936 | 7,561 | 7,529 | 8,041 | Other financial corporations |
| Korporata të tjera jofinanciare | 10,854 | 12,622 | 23,903 | 23,833 | 21,930 | Other nonfinancial corporations |
| Sektorë të tjerë rezidentë | 205,353 | 195,771 | 191,147 | 195,093 | 199,060 | Other resident sectors |

***Burimi*** *: Banka e Shqiperisë* ***Source*** *: Bank of Albania*

Tab - 13 **Tregues të shëndetit financiar (FSI)**

*(në përqindje)*

**Financial Soundness Indicators (FSI)**

(in percentage)

| Përshkrimi i treguesit | Janar'24 | Index description |
|---|---|---|
| **Tregues me bazë kapitalin** | | **Capital-based** |
| Kapitali rregullator ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik (në %) | | Regulatory capital as a percent of risk-weighted assets (in %) |
| Kapitali rregullator (mln lekë) | | Regulatory capital (million lek) |
| Aktive të ponderuara me rrezik (mln lekë) | | Risk-weighted assets |
| Kapitali rregullator i nivelit I ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik (në %) | | Regulatory Tier 1 capital as a percent of risk-weighted assets (in %) |
| Kapitali ndaj totalit të aktiveve | | Capital as a percent of total assets |
| Kapitali rregullator i nivelit I ndaj totalit të aktiveve | 8.67 | Regulatory Tier 1 capital as a percent of total assets |
| Kapitali rregullator ndaj totalit të aktiveve (në %) | 9.50 | Regulatory capital as a percent of total assets (in %) |
| Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve (në %) | 10.08 | Shareholders' equity as a percent of total assets (in %) |
| Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit (në %) | | Nonperforming loans net of provisions as a percent of capital (in %) |
| Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit rregullator të nivelit I (në %) | 6.31 | Nonperforming loans net of provisions as a percent of regulatory Tier1 capital (in %) |
| Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit rregullator (në %) | 5.77 | Nonperforming loans net of provisions as a percent of regulatory capital (in %) |
| Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit aksioner (në %) | 5.43 | Nonperforming loans net of provisions as a percent of shareholders' equity (in %) |
| Kthimi nga kapitali (ROE) (bazë vjetore) (në %) | 22.52 | Return on equity (ROE) (annual basis) (in%) |
| Pozicioni i hapur neto ne valutë ndaj kapitalit (në %) | | Net open position in foreign exchange as a percent of capital (in %) |
| Pozicioni i hapur neto ne valutë ndaj kapitalit rregullator të nivelit I (në %) | 5.01 | Net open position in foreign exchange as a percent of regulatory Tier 1 capital (in %) |
| Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregullator (në %) | 4.57 | Net open position in foreign exchange as a percent of regulatory capital (in %) |
| Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit aksioner (në %) | 4.31 | Net open position in foreign exchange as a percent of shareholders' capital (in %) |
| **Tregues me bazë aktivet** | | **Asset-based indicators** |
| Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (metoda e gjerë) | 32.27 | Liquid assets as a percent of total assets (broad measure) |
| Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (metoda bazë) | 31.85 | Liquid assets as a percent of total assets (core measure) |
| Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit) (metoda e gjerë) | 45.25 | Liquid assets as a percent of short-term liabilities (broad measure) |
| Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit) (metoda bazë) | 44.65 | Liquid assets as a percent of short-term liabilities (core measure) |
| Kthimi nga aktivet (ROA) (bazë vjetore) (fitimi neto para taksave) | 2.59 | Return on assets (ROA) (annual basis) (net profit before taxes) |
| Huatë me probleme (bruto) ndaj totalit të huave (në %) | 4.88 | Nonperforming loans (gross) as a percent of total loans (in %) |
| **Tregues të të ardhurave dhe shpenzimeve** | | **Income and expense-based** |
| Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto | 77.50 | Interest margin to gross income |
| Shpenzime jointeresi ndaj të ardhurave bruto | 45.85 | Noninterest expenses to gross income |
| **Të tjera** | | **Other** |
| Numri i bankave | 11.00 | Number of banks |

***Burimi*** *: Banka e Shqiperisë* ***Source*** *: Bank of Albania*